

“Avranos Enterprises Albania” sh.a

Selia: Bulevardi Blu, Qendër Kamëz, pallati 11 katësh, Kamëz
Tirana - Albania

**Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur me 31 Dhjetor
2013**

Tirane, 27 Mars 2014

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Përmbajtja

1. Raporti i audituesit
2. Bilanci Kontabël
3. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
4. Pasqyra e flukseve monetare
5. Pasqyra e ndryshmeve në kapital
6. Shënime

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Raporti i Audituesit

Ortakut të Shoqërisë

“Avranos Enterprises Albania” sh.a

Selia: Bulevardi Blu, Qendër Kamëz, pallati 11 katësh, Kamëz
Tirana - Albania

Unë kam audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Shoqërisë “Avranos Enterprises Albania” sh.a, (Shoqëria) të cilat përfshijnë bilancin kontabël për vitin që mbyllet më datën 31 Dhjetor 2013 dhe pasqyrën e ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve të veta dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për këtë vit si dhe shënimet shpjeguese, të përgatitura në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit aprovuar me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe udhezimin e Ministrit të Financave nr 4942 datë 15.06.2006 “Për Shpalljen e Standarteve Kontabël Kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqerte të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare që të mos përmbajnë anomali dhe gabime materiale, të cilat mund të kenë ndodhur për shkak të mashtrimit ose për shkak të gabimeve apo pasaktësirave, përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme për rrethanat

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia e imë është që, bazuar në auditimin e kryer, të shpreh një opinion mbi këto pasqyra financiare. Auditimin e kam kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përftojme siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale.

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencat e auditimit rreth shifrave dhe paraqitjeve në pasqyrat financiare. Këto procedura të cilat zgjidhen në varësi të gjykimit të audituesit, përfshijnë vlerësimin e rrezikut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, që mund të kenë ndodhur për shkak të mashtrimit ose të gabimeve. Për realizimin e vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqerte të pasqyrave financiare të shoqërisë me qëllim që hartojë procedura të auditimit të përshtatshme sipas situatës, por jo me qëllimin e shprehjes së një opinioni lidhur me efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë të politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmerinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Unë besoj se evidenca e auditimit që kam marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për t’u përdorur si baze në dhënien e opinionit tim të audituesit.

Opinion

Sipas opinionit tim pasqyrat financiare, të marra në tërësi dhe në të gjithë aspektet materiale, japin një pamje të vërtetë dhe të sinqerte të situatës financiare të shoqërisë “Avranos Enterprises Albania” sh.a, (Shoqëria), me 31 Dhjetor 2013, të rezultateve të veprimtarive të saj dhe të fluksit monetar për periudhën kontabël të mbyllur, të përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Firma : Alb BB Auditing

Lavdimir Fusha

Eksperti Kontabël i Regjistruar

Datë : 29 Mars 2014

Adresa: Rr. Blv Gjergji Fishta, Nd. 16, H.9, Ap.20
Tiranë -Albania

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

Bilanci Kontabël i datës 31 dhjetor 2013

<u>AKTIVET</u>	Shen	31.12.2013	31.12.2012
I Aktivet Afatshkurtëra			
1 Aktive monetare	4	15,743,092	3,497,672
3 Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
(i) Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	5	14,086,982	16,704,190
(ii) Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	6	4,042	4,042
Totali 3		14,091,024	16,708,232
4 Inventari			
(i) Lëndët e para	7	0	0
Totali 4		0	0
7 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		0	34,450,000
Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)		29,834,116	54,655,905
II Aktivet afatgjata			
2 Aktive afatgjata materiale			
(iv) Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	9	309,548	1,170,484
Totali 2		309,548	1,170,484
5 Kapital aksionar i paguar		0	260,016
Totali i aktiveve Afatgjata (II)		309,547	1,430,500
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		30,143,663	56,086,405
<u>DETYRIMET DHE KAPITALI</u>			
I DETYRIMET Afatshkurtëra			
3 Huat dhe parapagimet			
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	10	73,170,840	66,792,889
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	11	78,126	974,789
(iii) Detyrime tatimore	12	3,370,664	2,402,316
(iv) Hua të tjera	13	19,772,528	19,786,727
(v) Parapagimet e arkëtuara	14	6,596,963	6,855,375
Totali i detyr. afatshkurtra (I)		102,989,120	96,812,096
II DETYRIME AFATGJATA			
Totali i detyr. afatgjata (II)		-	0
Totali i detyrimeve		102,989,120	96,812,096
III Kapitali			
3 Kapitali aksionar	15	3,500,000	2,000,000
7 Fitimet e pashpërndara	15	-	-4,220,652
8 Fitimi (humbja) e vitit financiar	15	-	-
Totali i kapitalit (III)		33,619,765	38,505,039
TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT		-72,845,457	-40,725,692
TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT		30,143,663	56,086,405

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24



“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e të Ardhurave për periudhën që përfundon më 31.12.2013

	Shen	Viti 2013	Viti 2012
1 Shitjet neto	16.1	2,410,002	60,163,019
2 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	16.2	62,238,145	9,516,212
3 Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces		-	-
4 Materialet e konsumuara .	17	-6,426,508	-49,591,455
5 Kosto e punës	18	-	-
-Pagat e personelit	18	-1,008,868	-2,109,808
-Të tjera personeli	18	-	-
-Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetësore	18	-168,481	-352,340
6 Amortizimi dhe zhvleresimet	9	-90,476	-172,672
7 Shpenzime të tjera	19	-88,921,462	-54,353,036
8 Totali i shpenzimeve		-96,615,796	-106,579,310
9 Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore		-31,967,649	-36,900,079
12 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare:			
12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	20	-1,505,280	-1,417,063
12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	21	-146,837	-111,939
12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		-	-
13 Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		-1,652,117	-1,529,003
14 Fitimi (humbja) para tatimit	22	-33,619,765	-38,429,081
15 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	22	-	75,958
16 Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		-33,619,765	-38,505,039

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24



“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHJET

Pasqyra e ndryshimit të flukseve te mjeteve monetare për periudhën që përfundon
më 31.12.2013

	Shen	2013	2012
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit	22	-33,619,765	-38,505,039
<i>Rregullime për:</i>			
Tatim Fitimin e Njohur ne PASH	22	-	75,958
Shpenzime/ te ardhura për interesa te njohura ne PASH	20	1,505,459	1,417,063
Shpenzime te llogaritura		-	-
Amortizimi i Aktive Afagjata	9	90,476	172,672
Diferenca kursi kembimi	5,10,21	-272,008	-174,853
		<u>-32,295,838</u>	<u>-37,014,199</u>
Rritje/rënie në tepricën e Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	5	2,617,208	-4,536,977
Rritje/rënie në tepricën e Llogari/Kërkesa të arkëtueshme te tjera	6	0	178,341
Rritje/rënie në tepricën inventarit	7	-	5,066,082
Rritje/rënie në Shpenzimet e Shtyra		34,450,000	-34,450,000
Rritje/rënie në tepricën e Llogarive te Pagueshme (Furnitoreve)	10	6,649,960	61,200,683
Rritje/Rënie në detyrimet ndaj punonjësve	11	-896,663	900,863
Rritje/rënie në tepricën e Detyrimeve tatimore	12	968,347	2,343,694
Rritje/Rënie në tepricën e huarave të tjera	13	-1,519,659	2,993,376
Rritje/Rënie në prapagimet e arketuara		-258,412	7,131,922
Tatim mbi fitimin i paguar		-	-80,000
		<u>42,010,782</u>	<u>40,747,983</u>
<u>MM Neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</u>			
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Pagesa per Blerja e aktiveve afatgjata	9	-24,167	-877,295
Arketime nga shitja/nxjerrja Jashte perdorimit e aktiveve afatgjata	9	794,627	
<u>MM neto, e përdorur në aktivitetet investuese</u>		<u>770,460</u>	<u>-877,295</u>
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Emetimi i kapitalit aksionar	15	1,760,016	-
<u>MM neto e përdorur në aktivitetet financiare</u>		<u>1,760,016</u>	-
Diferenca Konvertimi te MM te mbajtura ne Monedhe te Huaj	21	-	-
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		<u>12,245,420</u>	<u>2,856,489</u>
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		<u>3,497,672</u>	<u>641,183</u>
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		<u>15,743,092</u>	<u>3,497,672</u>

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24

SHOQERIA Avranos Enterprises Albania sha
NIPTI L11408003V

Datë / /2014

DEKLARATE

Deklaroj se **Shoqëria Avranos Enterprises Albania sha** me **NIPT L11408003V** me administrator Znj. Daniela Doko dhe **aksionere:**

1. Shoqeria Avranos Limited Shoqeri e huaj perqindja e pjesemarrjes 100 %

ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2013 konform standarteve kombetare te kontabilitetit.

Hartuesi i pasqyrave financiare eshte:

Shoqeria IT-AL Consult shpk (**studio kontabiliteti**) me NIPT K31517194J, Kontabilist Njazi Halili.

Administratori i Shoqërisë

(emer ,mbiemer ,firme)

SHOQERIA
NIPTI

Avranos Enterprises Albania sha
L11408003V

Aktivët Afatgjatë Materiale me vlerë fillestare 2013

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2013	Shtesa	Pakesime	Gjendje 12/31/2013
1	Toka					0
2	Ndertime					0
3	Makineri, pajisje		1,128,383		942,383	186,000
4	Mjete transporti					0
5	Pajisje zyre e informatike,					0
6	Pajisje informatike (Software)			24,167		24,167
7	Te tjera ne shfrytezim (mobileri, pajisje, etj.)		292,481			292,481
8	Parapagime për AAM					0
9						0
	TOTALI		1,420,864	24,167	942,383	502,648

Amortizimi A.A.Materiale 2013

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2013	Shtesa	Pakesime	Gjendje 12/31/2013
1	Toka					0
2	Ndertime					0
3	Makineri, pajisje, vegla		152,889	46,948	147,756	52,081
4	Mjete transporti					0
5	Pajisje zyre e informatike,					0
6	Pajisje informatike (Software)			4,531		4,531
7	Te tjera ne shfrytezim (mobileri, pajisje, etj.)		97,492	38,997		136,489
8	Parapagime për AAM					0
9						0
	TOTALI		250,381	90,476	147,756	193,101

Vlera kontabël neto e Aktiveve afatgjatë materiale 2013

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2013	Gjendje VNK 12/31/2013
1	Toka			0
2	Ndertime			0
3	Makineri, pajisje, vegla		975,494	133,919
4	Mjete transporti			0
5	Pajisje zyre e informatike,			0
6	Pajisje informatike (Software)			19,636
7	Te tjera ne shfrytezim (mobileri, pajisje, etj.)		194,989	155,992
8	Parapagime për AAM			0
9				0
	TOTALI		1,170,483	309,547

Administratori



“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKË, PËRNDRYSHË SHKRUHET

23. Transaksionet me palet e lidhura

Shoqëria është e zotuar në masën 100% nga Shoqëria Avranos Limited e regjistruar në Qipro me numër unik 276108 dhe me seli në Nestoros 42, Kaimakli, P.C. 1026, Nicosia, Cyprus.

Sipas statutit të shoqërisë, organi më i lartë vendimmarrës është asambleja e ortakëve. Shoqëria drejtohet nga administratori i saj.

Shoqëria ka identifikuar pale të lidhura ashtu siç parashikohet nga SNK 24: Palet e lidhura.

Një paraqitje e gjendjeve të llogarive me palet e lidhura jepen në vijim:

Bilanci Kontabel:

periudha që perfundoi me 31 Dhjetor 2013

	2013	2012
Detyrimet në fund të vitit		
1. Hua të tjera	2,804,000	2,791,800
	2,804,000	2,791,800

24. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme që të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

20. Të ardhurat dhe shpenzime për interesa

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Te Ardhura nga Interesi	180	61
Shpenzime nga Interesi	(1,505,459)	-1,417,125
Total	-1,505,280	-1,417,063

21. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi

Paraqesin fitimet dhe humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve të shprehura në monedhë të huaj.

Paraqitja e tyre jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
<i>Fitimi nga Kurset e kembimit</i>		
Fitime nga azhormimi i Arkes/Bankes	30,437	29,495
<i>Humbje nga Kurset e kembimit</i>		
Humbje nga azhormimi i Arkes/Bankes	-177,274	-141,434
Total	-146,837	-111,939

22. Tatimi aktual

Shoqëria ka rezultuar me një humbje kontabël 33,619,765 lekë. Për llogaritjen e rezultatit tatimor të vitit 2013 shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si të panjohura per qellime fiskale një sërë shpenzimesh. Fitimi fiskal i shoqërisë për vitin 2013 rezulton 33,128,561 lekë

Llogaritja e shpenzimeve të panjohura, dhe e rezultatit fiskal për gjithë vitin 2013 paraqiten si në tabelën vijuese:

	Viti 2013
Pasqyra e rezultatit tatimor 2013	
Humbja e vitit 2013	-33,619,765
Korrigjimet e rezultatit sipas ligjit tatimor:	491,204
<i>Shpenzime me dok jo të rregullta</i>	
<i>Shpenzime të tjera</i>	491,204
Totali i shpenzimeve të panjohura	491,204
Fitimi/Humbja i tatueshem para mbartjes se humbjes fiskale	-33,128,561
Humbja fiskale e vitit 2013	-33,128,561
Norma e tatimit aktual mbi fitimin	10%
Tatimi aktual mbi fitimin 2013	-
Shpenzimi kontabel i tatimit mbi fitimin	-

Shoqëria përdor norma amortizimi sa normat tatimore (referoju shënimit 3.5 (ii)).

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHJET

18. Shpenzime personeli

Në shpenzimet per personelin, jane perfshire shpenzimet per paga, shperblime dhe sigurime shoqerore e shendetesore të llogaritura gjatë vitit 2013. Gjate vitit 2013 shoqeria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar ne përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqerore e shëndetsore për punonjësit.

Përbërja e nënzërit të shpenzimeve të pagave paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Kosto personelit		
Pagat	1,008,868	2,109,808
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore	168,481	352,340
Total	1,177,349	2,462,148

Në nënzërin e shpenzimeve për sigurimet shoqerore e shëndetsore paraqiten shuma e kontributeve që llogarit dhe paguan shoqëria mbi fondin e pagave të punonjësve. Kontributet janë llogaritur në përputhje me tarifatat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqerore e shëndetsore.

19. Shpenzimet e tjera

Përbërja e këtij zëri të shpenzimeve paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Sherbim punimesh dhe minimi	-	2,913,832
Qira Makinerie punuese	52,553,071	41,666,483
Mirembajtje per makinerite	5,400,000	7,966,907
Vlera kontabel e Aktiveve Afatgjata te shitura	794,627	-
Shpenzime Ligjore, Kontabel, Inxhinierike etj.	693,000	670,700
Materiale zyre, telefoni	49,014	-
Shpenzime per taksat	78,620	-
Te tjera	29,625,139	1,309,967
Diferenca kursi kembimi furnitore, kliente dhe te trete te tjere	-272,008	-174,853
Total	88,921,462	54,353,036

Shpenzimet e qerasë paraqesin kryesisht pagesat dhe llogaritjet e bëra për qeranë e makinerive punuese.

Shpenzimet e mirëmbajtjes paraqesin kostot e shërbimeve të kryera për makineritë punuese.

Shpenzimet e konsulencës paraqesin kostot e shërbimeve ligjore, kontabilitetit, noteriale, etj.

Shërbimet nga të tretët paraqesin kostot e riparimeve dhe mirëmbajtjeve, të shërbimit të sigurisë, etj.

Shpenzimet e tjera, paraqesin pagesat për transportin e punëtorëve, për transporte të tjera, dhe shpenzime te ndryshme, shperndarjen e shpenzimeve te hapjes se guores etj.

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

16. Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës.

16.1 Shitjet neto

Shoqëria realizon të ardhurat nga kryerja e shërbimit të punimeve për prodhim të materialeve inerte. Gajte vitit 2013 ky aktivitet është reduktuar shumë, për shkak të kalimit në qiradhenie të makinerive klientit të saj dhe jo në shërbim prodhimi produktesh.

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Te ardhura nga shitja e punimeve dhe shërbimeve	2,410,002	60,163,019
Total	2,410,002	60,163,019

16.2 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Shoqëria realizon të ardhura të tjera nga veprimtaria e dhenies me qira të makinerive punuese. Gjatë vitit 2013 për shkak të ndryshimit të objektivit të aktivitetit të saj, këto janë të ardhurat kryesore të saj. Detajimi i këtij zëri është si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Te ardhura nga qiraja e makinerive punese	61,419,680	9,516,212
Te ardhura nga shitja e AAM	818,466	-
Total	62,238,145	9,516,212

17. Shpenzimet e lëndëve të para e materialeve të tjera

Në këtë zë të PASH janë përfshirë kostoja e blerjes së materialeve të para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e shërbimit të qiradhenies. Ky zë është ulur ndjeshëm në raport me vitin e kaluar për shkak të kalimit në qiradhenie të makinerive. Në këtë zë, paraqitet kryesisht karburanti i konsumuar për makineritë dhe përfshin çmimin e blerjes plus dhe të gjitha shpenzimet e kryera për sigurimin e tyre, përfshirë edhe pjesën e Tvsh së pakredituar për efekte të normave të përcaktuara në udhëzimin nr. 17 datë 13.05.2008 ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar’. Një paraqitje e këtij zëri të PASH paraqitet si në tabelën vijuese:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Blerje Materiale Pune	-	3,251,290
Blerje materiale të ndryshme - Karburant për makinerite	6,426,508	46,340,165
Total	6,426,508	49,591,455

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERINDRYSHE SHKRUHJET

12. Detyrimet tatimore -vazhdim

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Shteti Sigurimet Shoqerore e Shendetsores	44,645	55,651
Shteti Tatim Mbi te Ardhurat Personale	15,999	17,945
Shteti- TVSh për tu paguar	3,310,020	2,328,720,34
Total	3,370,664	2,402,316

13. Hua të tjera

Paraqet shumën e detyrimeve afatshkurtra, të llogaritur për periudhën 2013 dhe që do të paguhet në vitin 2014.

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Detyrime huaje ndaj shoqërive	3,609,509	4,933,546
Detyrime huaje ndaj individëve	14,384,613	13,477,760
Interes i pagueshem	442,887	231,629
Shpenzime interesi te llogaritura	1,335,520	1,143,792
Total	19,772,529	19,786,727

14. Parapagimet e arkëtuara

Në këtë zë të bilancit paraqitet shuma e parapagimeve të marra nga klientët e cila do të zbritet gjatë periudhës së ardhshme 2014 kur te kryen shërbimet. Ky zë paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Parapagime te marra	6,596,963	6,855,375
Total	6,596,963	6,855,375

15. Kapitale e veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor 2013, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Kapitali i paguar	3,500,000	1,739,984
Kapitali i nenshkruar i papaguar	-	260,016
Fitimi (Humbja) i/e viteve te kaluar	-42,725,692	-4,220,652
Fitimi (Humbja) i/e vitit financiar	(33,619,765)	-38,505,039
Total	(72,845,457)	-40,725,692

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRIMET

10. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2013. Detyrimet ndaj furnitorëve në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit dhe diferencat kanë kaluar në rezultat. Përbërja e këtyre detyrimeve paraqiten si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Furnitore brenda vendit	48,795,844	54,524,436
Furnitore jashte vendit	24,374,996	12,258,452
Fatura per te Mberritur	-	10,000
Total	73,170,840	66,792,889

Në furnitorët e aktivitetit kryesor peshën kryesore e zë detyrimi ndaj furnitorëve për qiratë e makinerive, për blerjen e lëndës djegëse naftë për makineritë, etj.

Në furnitorët për fatura për t'u mbërritur për shërbimet e kryera per vitin 2013 nuk ka.

Dinamika e detyrimeve ndaj furnitorëve paraqitet si vijon:

Pershkrimi	
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	66,792,889
Rritjet Gjate periudhes ushtrimore	60,648,559
Pakesimit gjate periudhes ushtrimore	-54,348,884
Rritje/(pakesime) Diferencat e kembimit	78,275
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	73,170,839

11. Të pagueshme ndaj punonjësve

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet ndaj punonjësve për pagat muajin dhjetor dhe që janë paguar në vitin 2014.

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Detyrime per paga		
Punonjesit	78,126	974,789
Total	78,126	974,789

12. Detyrimet tatimore

Në këtë paraqiten detyrimet ndaj shtetit për Tatimin mbi të ardhurat personale si dhe detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të cilat janë paguar në vitin 2014. Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

8. Parapagimet dhe Shpenzimet e Shtyra

Ne daten e ndertimit te ketye pasqyarave ky ze paraqitet ne vleren zero. Te gjitha shpenzimet e shtyra nga periudhat e paraardhese jane shpernadre gjate vitit ushtrimor 2013.

9. Aktivet Afatgjata

Gjendja dhe shtesat e pakësimet e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2013 paraqiten si në tabelën vijuese:

Pasqyra e ndryshimit të AAM	Toka, Ndertime	Instalime, makineri e pajisje	Pajisje zyre e informatike	Te tjera ne shfrytetime (mobileri, pajisje, etj.)	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2013	-	1,128,383	-	292,481	1,420,864
Blerjet gjatë viti ushtrimor	-		24,167	-	24,167
Shitjet gjatë viti ushtrimor	-	(942,383)		-	(942,383)
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	-	-	-
Plusvlere/minusvlere rivlerësimi	-	-	-	-	-
Pakësime/Shtesa të tjera	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2013	-	186,001	24,167	292,481	502,648

Pasqyra e ndryshimit të Amortizimit të AAM materiale

	Toka, Ndertime	Instalime, makineri e pajisje	Pajisje zyre e informatike	Te tjera ne shfrytetime (mobileri, pajisje, etj.)	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2012	-	152,889	-	97,492	250,380
Amortizimi i periudhes ushtrimore	-	46,948	4,531	38,997	90,476
Humbje nga Testi i vleres gjate periudhes	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAGJM te shitura	-	(147,756)	-	-	(147,756)
Amortizimi i AAGJM te Nxjerra jashte perdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2013	-	52,081	4,531	136,489	193,101
Vlera neto me 31 Dhjetor 2012	-	975,494	-	194,989	1,170,484
Vlera neto me 31 Dhjetor 2013	-	133,920	19,636	155,992	309,547

Në bilanc Aktivet Afatgjata paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar. Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marrë parasysh kohën e hyrjes së AAM. Normat e amortizimit të përdorura (referoju shënimit 3.5 (ii)), janë në përputhje me kërkesat e SKK 4 për të siguruar një shpërndarje të saktë të kostos së AAM në koston e periudhave që ato përdoren për sigurimin e të ardhurave.

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

4. Mjetet monetare - vazhdim

Mjete Monetare ne monedhe te huaj prane bankave

Pershkrimi I Llogarive	31 Dhjetor 13	31 Dhjetor 12
Llogari Rrjedhese prane Bankave	-855	-677
Llogari Rrjedhese prane Bankave	5,678	-1,798
Llogari Rrjedhese prane Bankave	-202	6,242
Llogari Rrjedhese prane Bankave	-2,061	6,457
Llogari Rrjedhese prane Bankave	2,781	-
Total	5,341	10,224

5. Llogari/Kerkesa të arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientave gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2013. Ato paraqiten me vlerën neto nga zhvlerësimi nga borxhi i keq. Shoqëria nuk ka llogaritur borxh të keq për vitin 2013. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientave jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Kliente per sherbime - AEGEK Construcion s.a	4,132,712	4,114,731
Kliente per sherbime - Al-Gem sha	4,650,187	9,957,605
Kliente per sherbime - Copri Aktor sha	5,304,084	2,631,854
Total	14,086,982	16,704,190

Dinamika e të drejtave ndaj klientëve paraqitet si vijon:

Pershkrimi	Shuma
Gjendja 01 Janar 2013	16,704,190
Rritjet Gjate periudhes ushtrimore	77,590,448
Pakesimit gjete periudhes ushtrimore	(80,315,997)
Rritje/(pakesime) Diferencat e kembimit	108,340
Gjendja 31 Dhjetor 2013	14,086,981

6. Kerkesa të arkëtueshme të tjera

Në këtë zë të bilancit paraqiten kërkesat e shoqërisë ndaj të tretëve që nuk lidhen me shitjen e shërbimeve dhe të mallrave. Një paraqitje e detajuar e këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
TF i parapaguar	4,042	4,042
Total	4,042	4,042

7. Inventarët

Shoqëria përdor disa lloje të inventarve të nevojshëm për aktivitetin e vet. Ajo përdor metodën e inventarizimit periodik për evidentimin në kontabilitet të gjendjes dhe lëvizjes të inventarëve. Inventaret jane vleresuar me kosto e cila eshte konsideuar nga drejtimi i shoqerise si me e vogla e krahasuar me vleren neto te realizueshme. Inventarët në datën e ndërtimit të PF është në vlerën zero. Duhet heqru se nuk ka inventare

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

3.10 Provizionet

Provizioni njihet kur Shoqeria ka nje detyrim aktual qe ka lindur nga nje ngjarje e shkuar, shlyerja e te cilit pritet te shoqerohet me dalje te burimeve dhe mund te behet nje vleresim relativisht i sakte i shumes se detyrimit.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shoqëria zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimin aktual mbi fitimin. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korigjuar atë me shpenzimet e panjohjura sipas përcaktimit të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon ti paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

4. Mjetet monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë.

Konvertimi i gjendjes në monedhë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2013 të shpallur nga Banka e Shqipërisë, Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në rezultat. Gjendja e mjeteve monetare dhe te ngjashme në fund të periudhës 2013 paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31-Dhjetor-13	31-Dhjetor-12
Mjete monetare në banke	27,583	21,662
Mjete monetare në arkë	15,715,509	3,476,010
Total	15,743,092	3,497,672

Një paraqitje e shumave të vendosura në institucionet financiare jepet ne vijim:

Pershkrimi I Llogarive	31 Dhjetor 13	31 Dhjetor 12
Vendosje Ne lek		
Llogari Rrjedhese prane Bankave	22,244	11,438
Depozita prane Bankave		
Vendosje Ne Monedhe te huaj		
Llogari Rrjedhese prane Bankave	5,341	10,224
Depozita prane Bankave	-	-
Total	27,585	21,662

3.7 Detyrimet -vazhdim

Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë.

Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat e shërbimit të qiradhenies së makinerive që përbëjnë aktivitetin kryesor të shoqërisë, neto nga TVSH. Ato njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së shërbimit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

3.9 Përfitimet e personelit

(i) Kontributet për sigurime shoqërore dhe të ngjashme

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal, kryen pagesa në emer të saj dhe të punonjesve të saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Kostot perkatese të bera në emer të Shoqërisë ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave me ndodhjen e tyre.

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHJET

a) Kosto e Prodhimit të gatshëm dhe prodhimit në proces

Kosto e prodhimit të gatshëm dhe prodhimit në proces përfshin kostot direkte të lidhura që identifikohen për sasine të prodhuara si p.sh: kosto e punës së dorës, kosto e materialeve etj. Gjithashtu ato përfshijnë dhe shpenzimet e përgjithshme të prodhimit direkte dhe indirekte që lidhen me procesin e prodhimit. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit indirekte janë ato shpenzime të cilat mbesin konstante gjatë prodhimit pavarësisht sasine së prodhuar, si p.sh, qeraja e makinerive, shpenzimet e mirëmbajtjes së tyre etj. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit direkte janë ato shpenzime të prodhimit të cilat variojnë nga sasia e prodhuar si të tilla përmendim: koston e materialeve ndihmëse dhe koston e punës indirekte.

3.5 Aktivitet e Afatgjata Materiale (AAM)

(i) Njohja dhe vlerësimi

AAM vlerësohen në hyrje me koston historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka). Koston historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitet ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative.

(ii) Amortizimi

Amortizimi i AAM llogaritet dhe njihet në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e vlerës së mbetur me norma të cilat janë të percaktuara në ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Toka dhe aktivitet në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit të përdorura në ndërtimin e PF janë të paraqitura si më poshtë:

	<i>Norma Amortizimit</i>	
	%	<i>Metoda Llogaritjes</i>
Instalime, makineri e pajisje	20%	Me vlerën e mbetur
Mobilje dhe Orendi	20%	Me vlerën e mbetur

3.6 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqëria zbaton politikën e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

3.7 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtëra dhe afatgjata.

Detyrimet afatshkurtëra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe në detyrime të tjera

3.2 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (Vazhdim)

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3.3 Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientat dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka. Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientat e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientat ndodh derisa mallrat, produktet ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa.

Shoqëria vlerëson cdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient apo debitor dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma. Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës neto kontabël të aktivitetit dhe vlerës neto aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar, të diskontuara me normën e interesit efektive.

3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 “Inventarët”, kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha reziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të indentifikohen me besueshmëri. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti). Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të voglën midis koston (dhe vlerës neto të realizueshme). Kostoja matet me metodën FiFo Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuara të shitjes.

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHJET

3. Politikat kontabel kryesore

Një përmbledhje të pjesës më të madhe të politikave kontabel mbi bazën e të cilave janë përgatitur pasqyrat financiare janë paraqitur sa më poshtë:

3.1 Transaksionet me monedhat e huaja

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

i) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia (“monedha funksionale”). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

ii) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabel, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj datë. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi”.

3.1 Transaksionet me monedhat e huaja (vazhdim)

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2013 janë:

Data / Monedha	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Euro	140.2	139.59
USD	101.86	105.85

3.2 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM në dore dhe ato të mbajtura në banka. Në përputhje me SKK 7 “Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare”, Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshijnë MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak). Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshijnë investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollat e këmbimit, etj).

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPIJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Avranos Enterprises Albania sha, në vijim e quajtur “Shoqëria”, është themeluar sipas aktit të themelimit më datën 26.01.2011 dhe është regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit më datën 08.02.2011. Në momentin e themelimit ortak i vetëm i kapitalit prej 2,000,000 lekësh ishte shoqëria Avranos Limited e regjistruar në Qipro me numer unik 276108 dhe me seli në Nestoros 42, Kaimakli, P.C. 1026, Nicosia, Cyprus.

Gjate vitit 2013 ortaku i vetëm ka bërë një rritje kapitali në shumën 1,500,000 leke. Avranos Enterprises Albania sha është shoqëri aksionere. Kapitali është ndarë në 100 pjesë me vlerën nominale prej 35,000 lekë secila.

Në datën e këtyre PF struktura e zotërimit të kapitalit paraqitet si vijon:

Emri i ortakut	Numri i aksioneve	% e kapitalit
Avranos Limited	100	100
Toftali	100	100

Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tiranës me NIPT L11408003V

Më 31 Dhjetor 2013 shoqëria ka 1 punonjës. (Me 31 Dhjetor 2012 4 punonjës)

Aktiviteti i saj kryesor i shoqërisë, është gërmim, nxjerrje, përpunim dhe tregtim i gurëve të fraksionuar si dhe Import - Eksport i inerteve dhe materialeve të tjera të ndërtimit.

Administratori ligjor i shoqërisë është znj. Daniela Doko.

Adresa e Shoqërisë është : Rr. Bulevardi Blu, Qendër Kamëz, pallati 11 katësh, Kamëz, Tiranë.

2. Parimet e përgatitjes së pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabel

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 9228 datë 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit 1-14 (SKK) të publikuara bazuar në urdhërin e Ministrisë të Financave nr 4942 datë 15.06.2006 “ Për Shpalljen e Standarteve Kontabël Kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.

Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK dhe të ligjit nr. 9228 datë 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe paraqiten në shënimin vijues.

“Avranos Enterprises Albania” sh.a
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2013 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar për periudhën Janar - Dhjetor 2013			
	Kapitali aksionar	Fitimi i pashperndare	Totali
Pozicioni më 1 Janar 2012	2,000,000	-4,220,652	-2,220,652
Emetim i kapitalit aksionar	15		-
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël	15	-38,505,039	-38,505,039
Pozicioni më 31 dhjetor 2012	2,000,000	-42,725,692	-40,725,692
Emetim i kapitalit aksionar	15	1,500,000	1,500,000
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël	15	-33,619,765	-33,619,765
Pozicioni më 31 dhjetor 2013	3,500,000	-76,345,457	-72,845,457

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24

Pasqyrat Financiare “Avranos Enterprises Albania sha” janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë
 Më datë 27 Mars 2014

IT - AL Consult shpk
 Kontabilisti
 Njazi Halili

Njazi Halili



Administratori
 Daniela Doko

Daniela Doko